



A.nr.1994/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1994/2025, të datës 08.12.2025, të parashtruar nga ankuesi M.E, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me 30.03.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa më numër A.nr.1994/2025, e datës 08.12.2025, e parashtruar nga ankuesi, M.E.

II. Shfuqizohet Vendimi me numër protokolli 10836 i datës 25.11.2025, i Ushtruesit të Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

III. Obligohet Ushtruesit të Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për ndërmarrjen e veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, M.E (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), me datë 08.12.2025 ka parashtruar ankesë me numër 7746/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit

me numër protokoll 10836 të datës 25.11.2025, të Ushtruesit të Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës *(në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli)* bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.12.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërsa më datë 29.12.2025, ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Tutje, Kryetari i Këshillit pas pranimit të kërkesës së Kryetares së Kolegjit përmes Vendimit me numër VK/2026 dhe numër të protokollit 342/2026 të datës 21.01.2026, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.1994/2026, të parashtruar nga ankuesi edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave *(në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit)*, për vendosje meritore administroi këto prova : Ankesën me numër protokoll 7746/2025, të datës 08.12.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi për vazhdim të afatit nga KPMSHCK; Formularin e parashtrimit të ankesës të datës 08.12.2025; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë, të datës 19.12.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 29.12.2025, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura nga organi i punësimit; Vërtetimet e marrëdhënies së punës; Diplomë me numër Nr.2359, e datës 20.04.2010; Përshkrimet e detyrave të punës, i datës 18.06.2018; Kontratat e punës të ankuesit M.E; Akt emërimi i M.E i datës 17.01.2012; Vendim me numër Nr.1516/2011, i datës 10.06.2011; Vendim me numër Nr.817/2013, i datës 02.04.2013; Vendim me numër Nr.3654/2015, i datës 04.05.2015; Vendim me numër protokoll Nr.01/597, i datës 10.02.2016; Vendim me numër protokoll Nr.01-761, i datës 26.01.2018; Akt emërimi i M.E i datës 23.08.2018; Vendim me numër protokoll Nr.01-8454, i datës 05.09.2018; Vendim me numër protokoll Nr.01/11938, i datës 21.12.2018; Vendim me numër protokoll Nr.594, i datës 18.03.2025; Diploma me numër Nr.02-3472/95-2645; Akt emërimi i F.M, i datës 17.01.2012; Kontratat e punës të F.M; Vendim me numër Nr.3147/2025, i datës 06.07.2015; Vendim me numër Nr.5941/2015, i datës 15.12.2015; Vendim me numër protokoll Nr.01-3735, i datës 24.04.2018; Vendim me numër protokoll Nr.01-7903, i datës 14.09.2021; Akt emërimi i F.M, me numër Nr.33/2025, i datës 05.05.2025; Vendim me numër protokoll Nr.6407/25, i datës 28.08.2025; Akt emërimi i F.M, i datës 14.11.2025; Vendim me numër protokoll Nr.01-10484, i datës 12.11.2025; Kërkesë për transfer , e datës 11.11.2025; Vendim me numër protokoll Nr.01-10836, i datës 21.11.2025; Vendim me numër protokoll Nr.01-3434, i datës 21.04.2021; Rregullore(ZKM) Nr. 08/2024 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të ministrisë së mjedisit dhe planifikimit hapësinor dhe infrastrukturës; Organogrami i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Njësitë organizative, pozitat, klasat dhe numëri i pozitave;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave *(në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit)* duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi me datë 08.12.2025 është e palejuar, *sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, gjegjësisht sipas Akt emërimit të datës 23.08.2018, mbanë pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin dhe Përgatitjen e Testeve për Patentë Shoferë*.

Më tej, Ushtruesi i Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, përmes Vendimit 10836 të datës 21.11.2026, Udhëheqësin e Divizionit për Siguri Rrugore në Departamentin për Menaxhimin e Rrugëve, e ka caktuar Ushtrues Detyre të Drejtorit të Departamentit për Patentë Shoferë.

Ankuesi, kundër Vendimit 10836 të datës 21.11.2026, ka parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, për shkak të shkeljeve të parimeve të përgjithshme të LPPA-së, shkeljeve të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe shkeljes së ligjit material, andaj, kërkon aprovimin e tërësishëm si të bazuar të ankesës dhe anulimin e aktit të kontestuar.

Kolegji i Këshillit lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, analizoi legjislacionin e aplikueshëm në ndërlidhje me çështjen e emërimit të përkohshëm të ushtruesit të detyrës, gjegjësisht dispozitat e nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet: *1. Paragrafi 1. i nenit 35 të ligjit bazik ndryshohet si në vijim: 1. Në rast se një pozitë e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësi i nivelit të lartë drejtues i atij institucioni e cakton me vendim ushtruesin e detyrës për pozitën e lirë. Për kategorinë e nivelit të lartë drejtues, ushtruesin e detyrës e cakton titullari; 2. Paragrafi 3. i nenit 35 të Ligjit bazik riformulohet si vijon: 3. “Zyrtari publik nuk mund të caktohet si ushtrues detyre më gjatë se dymbëdhjetë(12) muaj përveç rasteve kur procedura e rekrutimit është shpallur por për arsye objektive pozita nuk është plotësuar”. 3. Paragrafi 4 i nenit 35 të ligjit bazik ndryshohet si në vijim: 4. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se një periudhë prej dy (2) viteve.; si dhe nenit 35 paragrafit 2 të ligjit bazik, Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit.*

Tutje sipas Vendimit me Nr.073/2024 të datës 29.03.2024 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, është miratuar Rregullorja (ZKM) Nr.08/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e cila ka për qëllim përcaktimin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, dhe në kuadër të së cilës rregullore janë paraparë Departamentet dhe Divizionet përkatëse, ku pozita e ankuesit e titulluar tani më Udhëheqës i Divizioni i Planifikimit dhe Zhvillimit të Programit (sipas përgjigjes në ankesë të datës 15.05.2025 për lëndën A.nr.769/2025), rezulton se hynë në kuadër të Departamentit për Patentë Shofer dhe Automjete, ndërsa, pozita Udhëheqësit të Divizionit për Siguri Rrugore hynë në Departamentin për Menaxhimin e Rrugëve.

Andaj, Kolegji i Këshillit, bazuar në dispozitat e lartë theksuara ligjore, konstaton se pretendimi i ankimor i ankuesit është i qëndrueshëm, ngase duke marrë për bazë se organi përkatës i punësimit ka strukturën e

vet organizative, rrjedhimisht Departamenti për Patentë Shofer dhe Automjete ka pesë (5) pozita të kategorisë së ulët drejtuese apo Udhëheqës të Divizionit brenda njësisë së vetë organizative, ku në mesin e tyre përfshihet edhe pozita e ankuesit, dhe në kuptim të nenit 35 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Patentë Shoferë, duhej të caktohej zyrtarja/i më i lartë i kategorisë pasuese nga ky departament, gjegjësisht do duhej të shfrytëzohen të gjitha mundësit që për arritjen e këtij qëllimi apo caktimin e Ushtruesit të Drejtorit të pozitës së lire të Drejtorit të Departamentit për Patentë Shofer dhe Automjete, ta mbulonte me njërin nga zyrtarët publik që është me akt emërim në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit në kuadër të Departamentit për Patentë Shofer dhe Automjete, e të cilët janë vartës të drejtpërdrejt të kësaj pozite së lirë, sikurse në rastin konkret ku kategoria pasuese e parë e raportimit ndaj kësaj pozite të kategorisë së mesme drejtuese, është pozita e ankuesit: Udhëheqës i Divizioni i Planifikimit dhe Zhvillimit të Programit, si dhe pozitat e katër (4) Udhëheqësve të Divizioneve tjera nëse veç posedojnë akt emërimi përkatëse, ndërsa faktikisht në rastin përkatës Ushtruesi i Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokolli 10836 të datës 21.11.2026, për caktimin e U.D Drejtorit të Departamentit për Patentë Shofer dhe Automjete, ka anashkaluar këto pozita të nivelit të ulët drejtues brenda këtij departamenti, rrjedhimisht ka caktuar një nëpunës nga një tjetër departament, gjegjësisht nga Departamenti për Menaxhimin e Rugëve.

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit, konstaton se Ushtruesi i Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokolli 10836 të datës 21.11.2026, përkatësisht me caktimin e Udhëheqësi të Divizionit për Siguri Rugore në Departamentin për Menaxhimin e Rugëve, në pozitën e Ushtruesit të Detyrës së Drejtorit të Departamentit për Patentë Shoferë, nuk ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike dhe juridike dhe gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 35 paragrafin 2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenin 9 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe me nenin 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, prandaj në kuptim të nenit 52 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i njëjti akt kontestues, rezulton si i paligjshëm dhe si i tillë është shfuqizuar sikurse në dispozitivin e këtij vendimi.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 paragrafi 4 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1994/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit M.E;
- U.D Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqëses së Divizionit të Personelit në MMPHI; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.